



GJYKATA KUSHTETUESE: SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT NUK KA PËRFUNDUAR

FAQE 4-5



Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim të martën që seanca konstituive e Kuvendit, e nisur më 15 prill, nuk ka përfunduar dhe që ajo duhet të përfundojë brenda 12 ditëve nga hyrja në

fuqi e këtij aktgjykimi. Gjykata e ka arsyetuar vendimin e saj, duke përmendur se ende nuk është zgjedhur nënkryetari i Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit serb. Ajo i ka

urdhëruar deputetët që në pajtim me nenet në fuqi ta ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në të mirë të interesit të Kosovës, kur ta zgjedhin nënkryetarin nga ky komunitet

**KURTI: DALLIMET
ME UASHINGTONIN
MUND TË LINDIN
PËR ÇËSHTJE
TAKTIKE, POR JO PËR
ATO STRATEGJIKE** F. 4



**DASH-i: KOSOVA
BËRI PËRPJEKJE,
POR JO
MJAFTUESHËM
KUNDËR
TRAFIKIMIT
TË NJERËZVE** F. 3



**LUFTHANSA DO TË SHKURTOJË
4 000 VENDE PUNE** F. 8

SPORT



**FIFA VENDOS: 6 500 TIFOZË NË
NDESHJEN SERBI - SHQIPËRI** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

VENDET MYSLIMANE DHE FUQITË EVROPIANE E MBËSHTETIN PLANIN E TRUMPIT PËR GAZËN

UASHINGTON, 30 SHTATOR - Kombet kryesore myslimane e kanë mbështetur planin e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, për t'i dhënë fund luftës në Rripin e Gazës, edhe pse disa palestinezë e quajten propozimin “farsë”.

Aleatët evropianë të Uashingtonit i bënë thirrje Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi evropian - ta pranojë propozimin amerikan.

Pas bisedimeve mes Trumpit dhe kryeministrit të Izraelit, Benjamin Netanyahu në Uashington të hënën, Shtëpia e Bardhë e publikoi një plan me 20 pika për Gazën. Plani parashikon armëpushim të menjëhershëm, shkëmbim të pengjeve që mbahen nga Hamasi me të burgosur palestinezë të mbajtur nga Izraeli, tërheqjen e Izraelit nga Gaza në faza, çarmatimin e Hamasit dhe krijimin e një qeverie tranzitore të udhëhequr nga një trup ndërkombëtar. Tetë shtete arabe ose me shumicë myslimane thanë në një deklaratë të përbashkët se e “përsëritnin rolin e presidentit amerikan dhe përpjekjet e tij të sinqerta që synojnë t'i japin fund luftës në Gazë”.

Ata thanë se “konfirmojnë gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive me Shtetet e Bashkuara dhe palët e tjera drejt finalizimit të marrëveshjes dhe sigurimit të zbatimit të saj”.

Vendet përfshijnë Egjiptin, Jordaninë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Turqinë. Të gjitha këto vende e njohin Izraelin, megjithëse

disa kanë marrëdhënie të trazuara. Deklaratën e nënshkruan gjithashtu Katari, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm ndërmjetësues, dhe Arabia Saudite. Indonezia dhe Pakistani, dy vendet më të populluara me shumicë myslimane në botë, iu bashkuan gjithashtu deklaratës.

Indonezia ka ofruar trupa si pjesë e një force të ardhshme në Gazë, ndërsa Pakistani është përpjekur të afrohet me Trumpin dhe të përmirësojë marrëdhëniet me Uashingtonin.

Autoriteti Palestinez, të cilin Netanyahu është përpjekur ta lërë mënjane, gjithashtu nxitoi të ofrojë mbështetje, duke përsëritur “përpjekjet e sinqerta dhe të vendosura” të Trumpit.

Hamasi ka thënë se do ta vlerësojë planin e Trumpit, para se të japë përgjigje.

Por, Xhihadi Islamik, një grup i armatosur palestinez që lufton krah Hamasit në Gazë, e quajti planin “një recetë për agresion të vazhdueshëm kundër popullit palestinez”.

Banorët e Gazës së shkatërruar nga lufta shprehën skepticizëm për planin, duke e hedhur poshtë si mashtrim për lirin e pengjeve që nuk do t'i japë fund luftës. “Ne si popull nuk do ta pranojmë këtë maskaradë”, tha Abu Mazen Nassar, 52 vjeç.

Fuqitë evropiane mbështesin planin

Presidenti francez, Emmanuel Macron, u takua javën e kaluar me

Trumpin dhe tha se Shtetet e Bashkuara po adoptonin elementë të një plani francez, pavarësisht mosmarrëveshjeve mbi njohjen e një shteti palestinez nga Franca.

Macron vlerësoi “angazhimin e Trumpit për t'i dhënë fund luftës në Gazë”.

“Hamas nuk ka zgjidhje tjetër përveçse t'i lirojë menjëherë të gjithë pengjet dhe të ndjekë këtë plan”, shkroi Macron në X.

Ai gjithashtu i bëri thirrje Izraelit të angazhohet “me vendosmëri” ndaj tij.

Zyra e kryeministrit britanik Keir Starmer tha se Mbretëria e Bashkuar “i mbështet fuqishëm përpjekjet e Trumpit për t'i dhënë fund luftimeve, për lirin e pengjeve dhe sigurimin e ndihmës humanitare urgjente për popullin e Gazës”.

Plani përfshin një thirrje për një qeveri tranzitore në Gazë të drejtuar nga Trump dhe me pjesëmarrjen e ish-kryeministrit britanik, Tony Blair. “Presidenti Trump ka paraqitur një plan të guximshëm dhe inteligjent, i cili, nëse pranohet, mund t'i japë fund luftës, të sjellë lehtësim të menjëhershëm në Gazë, shansin për një të ardhme më të ndritur dhe më të mirë për popullin e saj, duke siguruar njëkohësisht sigurinë absolute dhe të qëndrueshme të Izraelit dhe lirin e të gjithë pengjeve”, tha Blair në një deklaratë.

Presidenti i Këshillit të BE-së, Antonio Costa, u bëri thirrje të gjitha palëve që “ta shfrytëzojnë këtë moment për t'i dhënë paqes një shans të vërtetë”, duke shtuar



se “situata në Gazë është e papërballueshme”.

Qeveria e djathtë e kryeministres italiane Giorgia Meloni, e cila është përballur me presion në rritje për qëndrimin e saj të kujdesshëm, gjithashtu vlerësoi diplomacinë e Trumpit.

Në një deklaratë, ajo u bëri thirrje “të gjitha palëve ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të pranojnë planin”.

Ministri i Jashtëm gjerman Johann Wadephul tha se plani i Trumpit “ofron një mundësi

unike për t'i dhënë fund luftës së tmerrshme në Gazë. “Më në fund, ka shpresë për izraelitët dhe palestinezët që kjo luftë të përfundojë së shpejti”, tha ai.

Kryeministri spanjoll Pedro Sanchez - i cili e ka akuzuar Izraelin për kryerjen e “gjenocidit” në Gazë - tha se Madridi “e mirëpret propozimin për paqe”. “Ne duhet t'i japim fund kësaj shumë vuajtjesh,” tha ai, duke shtuar se një zgjidhje me dy shtete ishte “e vetmja e mundshme”.

QEVERIA AMERIKANE, BUZË MBYLLJES SË PARË PAS GATI SHTATË VJETËSH

Uashington, 30 shtator - Një mosmarrëveshje mes partive për shëndetësinë dhe shpenzimet mund ta shkaktojë mbylljen e Qeverisë amerikane për herë të parë pas gati shtatë vjetësh.

Demokratët dhe republikanët në Kongres nuk po arrijnë dot marrëveshje, pavarësisht se mijëra punonjës federalë rrezikojnë të dërgohen në pushim të detyruar nga puna ose të shkarkohen.

Qeveria do të mbyllet në orën 12:01 të mëngjesit të së mërkurës, nëse Senati nuk e kalon një projektligj të Dhomës së Përfaqësuesve, i cili do ta zgjaste financimin federal për shtatë javë, për t'u dhënë kohë ligjvënësve ta përfundojnë punën mbi projektet vjetore të shpenzimeve.

Demokratët në Senat thonë se nuk do ta votojnë projektligjin, nëse ai nuk përfshin zgjatjen e benefiteve shëndetësore që po



skadojnë, mes kërkesave të tjera.

Presidenti Donald Trump dhe republikanët nuk duan bile as të bisedojnë, duke argumentuar se bëhet fjalë për një projektligj të “pastër” që nuk duhet të jetë i diskutueshëm.

Nuk është e qartë nëse ndonjëra

palë do të lëshojë pe para afatit.

“Tani është në duart e presidentit”, tha të hënën udhëheqësi demokrat i Senatit, Chuck Schumer, pas një takimi në Shtëpinë e Bardhë me Trumpin, i cili nuk duket se solli ndonjë përparim të dukshëm. “Ai

mund ta shmangë mbylljen nëse arrin t'i bindë udhëheqësit republikanë të pranojnë atë që duam ne”, tha ai.

Nënpresidenti JD Vance, i cili gjithashtu ishte në takim, tha: “Mendoj se po shkojmë drejt mbylljes, sepse demokratët nuk po e bëjnë gjënë e duhur”.

Edhe ngërçet mes partive mbi shpenzimet e Qeverisë janë të shpeshta në Uashington, ngërçi i tanishëm vjen në një moment kur demokratët e shohin si një mundësi të rrallë për ta përdorur ndikimin e tyre për të arritur synime politike, pasi elektorati i tyre kërkon përballje me Trumpin.

Republikanët, të cilët kanë një shumicë 53-47 në Senat, ka të mundësi të kenë nevojë për të paktën tetë vota nga demokratët për ta kaluar ligjin me 60 vota, pasi senatori republikan Rand Paul nga Kentaki pritet të votojë kundër.

Trumpi nuk ka treguar shumë interes për të pranuar kërkesat e demokratëve për shëndetësinë, edhe pse u pajtua për një takim me ta të hënën. Para se të hynte në takim, ai e bëri të qartë se nuk kishte ndër mend të negocionte sipas kushteve të demokratëve.

“Ideja e tyre nuk është shumë e mirë”, tha Trump.

Ndërkohë, agjencitë federale po shpërndajnë plane emergjente në rast se financimi ndërpritet, përfshirë hollësi për atë se cilat zyra do të qëndrojnë të hapura dhe cilët punonjës do të shkojnë në pushim të detyruar.

Russ Vought, drejtori për buxhet i Trumpit, u tha gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë se mbyllja do të menaxhohej “siç duhet, por kjo është diçka që mund të shmanget plotësisht”, nëse demokratët e Senatit pranojnë projektligjin e miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve.

Protesta studentore e 1 tetorit 1997 mobilizoi popullin

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Të mërkurën bëhen 28 vjet nga protesta e Lëvizjes Studentore e vitit 1997. Ishte Lëvizja Studentore e atëhershme që organizoi protestat të cilat u organizuan për ta kundërshtuar pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe kthimin e studentëve në objektet universitare, nga të cilat studentët ishin dëbuar nga regjimi i Slllobodan Millosheviqit në fillim të viteve '90. Përpos masave të dhunshëm që regjimi kishte vendosur vite më

parë në universitet, dëboi studentë dhe profesorë nga universiteti dhe imponoi planprogramin serb për mësim. Kjo protestë konsiderohet një ndër aktet më të rëndësishme të asaj kohe. Për ta shpërndarë protestën paqësore, policia serbe përdori dhunë ndaj studentëve dhe profesorëve. Në ballë të kësaj proteste ishin liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, së bashku me rektorin e

atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci. Pas tyre në këtë protestë ishin edhe mijëra studentë dhe profesorë. Lëvizja Studentore e '97-s u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytetarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotor të luftës për liri dhe pavarësi. Kjo ngjarje, kanë thënë më herët profesorët universitarë, duhet të shënohet në tekstet shkollore dhe të kujtohet nga gjeneratat e reja si akt sublim i fillimit të procesit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.



DASH-i: KOSOVA BËRI PËRPPJEKJE, POR JO MJAFTUESHËM KUNDËR TRAFIKIMIT TË NJERËZVE

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara e renditën Kosovën në Nivelin 2 në raportin e fundit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Kjo kategori përfshin vendet ku qeveritë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të luftuar trafikimin e njerëzve, por ende nuk arrijnë t'i përmbushin plotësisht standardet minimale ndërkombëtare. Në të njëjtën kategori renditen edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut. Raporti, i publikuar më 29 shtator nga Departamenti Amerikan i Shtetit, vë në pah se Kosova ka shtuar përpjekjet për ta luftuar trafikimin krahasuar me vitin e kaluar, duke përfshirë ndjekjen penale të një numri më të madh personash të dyshuar për trafikim dhe identifikimin e shumë viktimave. Gjithashtu, është rritur edhe financimi për mbështetjen e viktimave, si dhe fondit për kompensimin e tyre. Megjithatë, qeveria nuk i ka përmbushur disa standarde minimale në fusha kyçe, ndaj Kosova mbetet në Nivelin 2, sikurse edhe në raportimin e mëparshëm. Mangësitë kryesore përfshijnë: dënimin e paktë të trafikantëve dhe shqiptimin e dënimeve nën



minimumin e parashikuar me ligj. Raporti, gjithashtu, thekson se rastet e fëmijëve të detyruar nga prindërit për të lypur rrugëve, trajtohen shpesh si neglizhencë ose keqtrajtim, e jo si trafikim, duke ngritur shqetësime për identifikimin e pasaktë të viktimave. "Qeveria nuk ka pasur kapacitet për të ofruar ndihmë afatgjatë dhe ka ndarë më pak fonde për fushatat e ndërgjegjësimit", thekson raporti. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit kujton se ligji në Kosovë penalizon trafikimin për qëllime seksuale dhe të punës me dënime deri në 15 vjet burg, por thekson se zbatimi i tij ka qenë i mangët.

Vitin e kaluar autoritetet ndoqën penalisht 17 raste të reja që përfshinin 49 trafikantë të dyshuar, krahasuar me tetë raste në vitin 2023, që përfshinin 10 trafikantë të dyshuar. Autoritetet vazhduan të ndiqnin penalisht edhe gjashtë raste me 14 trafikantë të dyshuar, të iniciuara në vitet e mëparshme. Por, gjykatat dënuan vetëm një trafikant seksual - një rënie kjo e madhe krahasuar me 14 trafikantë të dënuar në vitin 2023, thekson raporti. Ai u dënua me tetë muaj burgim, që ishte nën dënimin minimal prej pesë vjetësh burgim. Dënimet nën këtë minimum dëmtojnë përpjekjet për t'i

mbajtur trafikantët përgjegjës dhe nuk pasqyrojnë seriozitetin e krimit, thuhet në raport. Por, krahas mangësive, dokumenti nxjerr në pah edhe përmirësimet në mbrojtjen e viktimave. Gjatë vitit të kaluar u identifikuan 14 viktima, krahasuar me 17 viktima në vitin 2023, dhe shumica e tyre morën asistencë ligjore, mjekësore dhe psikologjike, këshillim, edukim dhe mbështetje për riintegrim. Qeveria, sipas raportit, ka rritur financimin për këto shërbime, duke alokuar 150.000 euro për qendrën e sigurisë për viktimat e rrezikuara, krahasuar me 75.000 euro të ndara në vitin 2023. Gjithashtu, fondit për kompensimin e viktimave është rritur në 200.000 euro vitin e kaluar, krahasuar me 150.000 euro në vitin 2023. Për periudhën e ardhshme, raporti thekson se Kosova duhet të përforcojë dukshëm përpjekjet kundër trafikimit. Mes rekomandimeve kryesore përmenden hetimi dhe ndjekja penale e trafikantëve dhe shqiptimi i dënimeve të rënda. Raporti sugjeron, gjithashtu, trajnime të avancuara për gjyqtarët, prokurorët dhe policinë për identifikimin e trafikimit dhe qasjen e përshtatshme të viktimat.

Kapacitetet dhe financimet për qendrat sociale dhe strehimoret e organizatave joqeveritare, rekomandohet të rriten, ashtu si edhe mbështetja për trajnime profesionale dhe integrim të viktimave.

Kush është më i cenueshëm ndaj trafikimit?

Trafikimi prek të gjitha komunitetet në Kosovë, sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit. Gratë dhe vajzat rekrutohen me premtime të rreme për martesë ose punë si këngëtare dhe valltare, por më pas trafikohen seksualisht në shtëpi private, klube nate ose qendra masazhi. Viktimat përfshijnë jo vetëm kosovare, por edhe gra nga Shqipëria, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe vende të tjera evropiane. Kosovarët, po ashtu, shpesh detyrohen të bëjnë punë seksuale dhe të tjera në Evropë. Në anën tjetër, fëmijët nga Kosova, Shqipëria dhe vendet fqinje shpesh shfrytëzohen për lypje të detyruar. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë veçanërisht të rrezikuara, ashtu si edhe personat LGBTQ+, migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët.

Protestohet për lirimin e ish-policit Arbnor Spahiu nga paraburgimi në Serbi

PRISHTINË, 30 SHTATOR - "Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar", "Arbnor Spahiu nuk është vetëm, jemi të gjithë bashkë", "Drejtësi për Arbnorin" ishin vetëm disa nga parullat e qytetarëve që protestuan në Prishtinë të martën, duke kërkuar lirimin nga paraburgimi në Serbi të ish-policit Arbnor Spahiu, i cili u arrestua në qershor. Gjykata e Lartë në Suboticë kishte vendosur masën e

paraburgimit ndaj Spahiut, pasi dyshohet për kryerjen e veprës penale "vrasje e rëndë". Ai është arrestuar në qershor të këtij viti nga autoritetet serbe në pikën kufitare ndërmjet Hungarisë dhe Serbisë dhe akuzohet për kryerjen e kësaj veprë penale në fshatin Banjskë të Zveçanit. Nga ky sulm mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku, ndërsa nga përleshjet që pasuan

humbën jetën tre sulmues serbë. Sipas ligjit në Serbi, "vrasja e rëndë" dënohet me një dënim minimal prej dhjetë vjetësh burg ose me burgim të përjetshëm. Spahiu mbetet i ndaluar nga autoritetet serbe në pikën kufitare mes Hungarisë dhe Serbisë, ndërsa kërret institucionalë kanë deklaruar se janë të angazhuar maksimalisht për lirimin e tij.





KURTI: DALLIMET ME UASHINGTONIN MUND TË LINDIN PËR ÇËSHTJE TAKTIKE, POR JO PËR ATO STRATEGJIKE

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në diskutimin e organizuar nga Hudson Institute me temë “Partneriteti në rritje Kosovë - ShBA në mbrojtje dhe zhvillim” në Uashington. Aty Kurti foli edhe për raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Sipas tij, dallimet me Uashingtonin mund të lindin për çështje taktike, por për strategjinë dhe vlerat janë në të njëjtën linjë. “Drejtimi është i qartë: Kosova dhe Shtetet e Bashkuara janë të bashkuara në interesa dhe po përparojnë së bashku drejt qëllimeve të përbashkëta”, ka thënë Kurti

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

UASHINGTON, 30 SHTATOR - Në Uashington D. C. kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në diskutimin e organizuar nga Hudson Institute me temë “Partneriteti në rritje Kosovë - ShBA në mbrojtje dhe zhvillim”. Në këtë diskutim, Kurti ka theksuar se partneriteti i qeverisë së tij është i ndërtuar mbi tri shtylla: diplomaci, mbrojtje dhe zhvillim. Ai ka theksuar se në diplomaci herë pas here përballet me dallime, veçanërisht në lidhje me Serbinë dhe strukturat ilegale që ajo mban në Kosovë. “Por këto dallime kanë të bëjnë me taktikat dhe operacionet, jo me vlerat apo qëllimet strategjike. Në këto çështje jemi plotësisht në linjë të njëjtë. Në zhvillim, përparimi është po aq i rëndësishëm”, ka thënë ai.

Kurti ka thënë se qeveria në drejtimin e tij uli në mënyrë të njëanshme në 0 % tarifat e importit për të gjitha mallrat e prodhuara në ShBA, duke

forcuar lidhjet tregtare dhe duke nxitur më tej investimet amerikane. Ai ka treguar se Shtetet e Bashkuara vazhduan Programin Kompakt të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Kosovën - granti më i madh i ShBA-së në historinë tonë, mbi 200 milionë dollarë amerikanë. “Fokusi i saj në ruajtjen e energjisë në bateri do ta modernizojë sektorin tonë të energjisë, do të ndihmojë në uljen e importeve dhe në integrimin e burimeve të reja të rinovueshme, dhe do të sigurojë qëndrueshmëri afatgjatë. Ndërkohë, General Electric dje përfundoi modernizimin e një prej njësive të termocentralit tonë kryesor Kosova B, për ta vazhduar punën në njësinë tjetër vitin e ardhshëm. Kjo është politikë zhvillimi, por edhe siguri energjetike”, është shprehur Kurti, duke shtuar se Kosova u është përgjigjur pozitivisht kërkesave të ShBA-së në fusha të tjera, duke përfshirë strehimin e përkohshëm të deri në 50 shtetasve të vendeve të treta në vitin 2025, në përputhje me

standardet ndërkombëtare humanitare. “Kjo dëshmoi gatishmërinë tonë për t'i mbështetur prioritetet e përbashkëta globale. E gjithë kjo ndodh në një mjedis të ndërlidhur rajonal. Presidenti Putin po llogarit në përçarjen perëndimore. Presidenti Vuçiq në Beograd po mundohet të blejë kohë, duke shfrytëzuar përçarjet midis institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare, ndërkohë që refuzon ta sanksionojë Rusinë dhe mban lidhje të ngushta sigurie dhe ekonomike me Moskën. Kritikat javore ndaj regjimit të tij rrallë përkthehen në veprime vendimtare të BE-së. Në të njëjtën kohë, në Serbi dhe më gjerë qarkullojnë narrativa që portretizojnë udhëheqësit si Xi Jinping dhe Vladimir Putin si të preferueshëm ndaj modeleve demokratike perëndimore. Kjo retorikë ringjall nocionin e vjetër të ‘mos-rreshtimit’, por në praktikë do të thotë të fshihesh nën ombrellën e shumëfishtë deri në momentin e duhur për lëvizje destabilizuese në kërkim të një Serbie të Madhe. Brenda vendit autoritetet serbe i shpërfillin aktorët civilë dhe protestuesit si ‘kukulla të OJQ-ve perëndimore’, një gjuhë që i bën jehonë metodave të Lukashenkos dhe kërkon ta delegjitimojë shoqërinë civile të pavarur. Këto trendë janë të rrezikshëm. Një fitore e Rusisë në Ukrainë do t'i inkurajonte ambiciet revizioniste të Serbisë në Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë”, ka thënë Kurti.

Në këtë kontekst, Kurti ka thënë

se Kosova është një vijë e parë mbrojtëse kundër ndikimit keqdashës. “Institucionet tona janë të forta, transparente dhe të lidhura ngushtë me partnerët perëndimorë. Me Kampin Bondsteel, praninë e vazhdueshme të KFOR-it dhe bashkëpunimin tonë dypalësh në rritje me Shtetet e Bashkuara, Kosova është një forcë stabilizuese në Evropën Juglindore. Për këto arsye ne nuk mund të jemi pasivë. Rreshtimi ynë me Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n është parimor dhe pragmatik. Ne vendosim sanksione kur është e nevojshme, mbështesim Ukrainën, forcojmë mbrojtjen tonë dhe ndërtojmë zhvillim të qëndrueshëm. Dallimet me Uashingtonin mund të lindin për çështje taktike, por për strategjinë dhe vlerat jemi në të njëjtën linjë. Drejtimi është i qartë: Kosova dhe Shtetet e Bashkuara janë të bashkuara në interesa dhe po përparojnë së bashku drejt qëllimeve të përbashkëta”, ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se Kosova nuk po kërkon të shihet vetëm si përfituese e mbështetjes së NATO-s dhe ShBA-së. “Ne jemi një kontribuues sigurie, një partner zhvillimi ose një aleat i palëkundur. Në një rajon ku ndikimi rus shfrytëzon përçarjet, Kosova qëndron fort me Shtetet e Bashkuara - në fjalë, në politika dhe në veprime. Pres me padurim diskutimin e sotëm se si mund ta thellojmë më tej këtë bashkëpunim, në mbrojtje, në zhvillim dhe në sigurimin e sigurisë së qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor”, ka

deklaruar Kurti.

Kurti një ditë më parë, gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, tha se arsyeja pse Uashingtoni ka pezulluar Dialogun e planifikuar Strategjik me Kosovën ka të bëjë me mbylljen e strukturave serbe në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. I pyetur gjatë një bashkëbisedimi ta sqaronte arsyen e vendimit të kumtuar nga ShBA-ja më 12 shtator, Kurti tha se ai nuk mund të bëjë kompromise me sundimin e ligjit. “[Arsyeja e pezullimit të Dialogut të planifikuar Strategjik] është për shkak të sundimit të ligjit në veri të Kosovës, i cili rezultoi të ishte kundër strukturave ilegale serbe dhe këtu nuk mund të bëj kompromise. Nuk mund t'ia lë këtë problem brezit tuaj. Mendoj që brezi im është ai që duhet ta përfundojë këtë”, tha Kurti.

Ndërkaq analistët politikë kanë reaguar ashpër ndaj qëndrimeve të fundit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ndaj ShBA-së, duke i cilësuar deklaratat e tij kontradiktore dhe të rrezikshme për interesat strategjike të Kosovës. Njohësi i proceseve politike në vend, Ismet Kryeziu, ka thënë se akuzat e fundit të Kurtit ndaj ShBA-së, se gjoja veprimet e saj janë kundër sundimit të ligjit në veri dhe janë kërkesa për ‘kusuritje’ me Serbinë e Rusinë në kurrit të Kosovës, përbëjnë një theqafje politike për vendin. E Visar Ymeri ka theksuar se “nuk qenka problem (i Kurtit) ndikimi rus në Serbi, por ndikimi amerikan në Kosovë. A është duke e ditur Kurti se çfarë po flet?”.

GJYKATA KUSHTETUESE: SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT NUK KA PËRFUNDUAR

Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim të martën që seanca konstituive e Kuvendit, e nisur më 15 prill, nuk ka përfunduar dhe që ajo duhet të përfundojë brenda 12 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi. Gjykata e ka arsyetuar vendimin e saj, duke përmendur se ende nuk është zgjedhur nënkryetari i Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit serb. Ajo i ka urdhëruar deputetët që në pajtim me nenet në fuqi ta ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në të mirë të interesit të Kosovës, kur ta zgjedhin nënkryetarin nga ky komunitet



PRISHTINË, 30 SHTATOR - Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim të martën që seanca konstituive e Kuvendit, e nisur më 15 prill, nuk ka përfunduar dhe që ajo duhet të përfundojë brenda 12 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi. Gjykata e ka arsyetuar vendimin e saj, duke përmendur se ende nuk është zgjedhur nënkryetari i Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit

serb.

Ajo i ka urdhëruar deputetët që në pajtim me nenet në fuqi ta ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në të mirë të interesit të Kosovës, kur ta zgjedhin nënkryetarin nga ky komunitet.

Gjykata e ka marrë këtë vendim pas ankesës së Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - lidhur me votimin ndaras të kandidatëve

për nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës nga radhët e pakicave. Emilija Rexhepi është zgjedhur nënkryetare e Kuvendit nga minoriteti joserb, ndërsa asnjëri deputet serb nuk i ka siguruar votat e nevojshme pavarësisht disa raundeve të votimit.

Lista Serbe beson se kryetari i

Kuvendit, Dimal Basha, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë kur e ka shpallur Kuvendin të konstituuar pa u zgjedhur edhe nënkryetari serb.

Pas pranimit të ankesës, Gjykata Kushtetuese ka vendosur një masë të përkohshme, e cila ua ka ndaluar deputetëve të

ndërmarrin veprime drejt formimit të qeverisë së re deri më 30 shtator, meqë ka pasur dyshime për ndonjë shkelje kushtetuese.


Lëvizja Vetëvendosje, parti që ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet e 9 shkurtit dhe aktualisht është në pushtet, e ka kritikuar masën e vendosur nga Kushtetuesja, ndërsa presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë ditë më parë se beson që bllokimi i Kuvendit për shkak të moszgjedhjes së nënkryetarit nga pakica serbe, përderisa kryesia e tij ka kuorum, do t'i cenonte në mënyrë serioze themelet mbi të cilat është ndërtuar shteti. Sipas saj, votimi në pako për dy pozitat e rezervuara për minoritetet nuk kërkohet me Kushtetutë, siç pretendon Lista Serbe dhe se Rregullorja e Punës e Kuvendit nuk është mbi dokumentin më të rëndësishëm në vend.

ZËVENDËSI I KOUCHNERIT TREGON SE THAÇI E KISHTE DËNUAR DHUNËN NDAJ PAKICAVE ETNIKE

Hagë, 30 shtator - Në Gjykatën Speciale në Hagë të hënë ka nisur dëshminë James Peter Covey, ish-zëvendës i Bernard Kouchnerit, i cili ka shërbyer në Kosovë si përfaqësues special i sekretarit të OKB-së në Kosovë. Gjatë dëshmisë së tij në Dhomat e Specializuara në Hagë, James Peter Covey ka rrëfyer për një takim të mbajtur në shtator të vitit 1999, kur Bernard Kouchner kishte udhëtuar në Kosovë për t'i bindur komandantët e zonave të UÇK-së që t'i përmbushnin kushtet e demilitarizimit.

Covey ka thënë se në këtë takim Hashim Thaçi nuk kishte folur fare dhe se marrëdhënia e tij me komandantët e zonave ishte e ndërlikuar. “Kjo më kujtohet fare qartë se dukej sikur po konfirmonte fuqishëm atë që ne besonim që në fillim lidhur me zotin Thaçi kur jemi njohur me atë. Pra, që ai kishte një marrëdhënie të vështirë-ndërlikuar me komandantët e UÇK-së në terren dhe se ata kishin pak kohë ose më mirë thënë kishin shfaqur mungesë respekti ndaj tij”, ka thënë dëshmitari Covey.

Para këtij rrëfimi atij i është paraqitur një pikturë e vendosur në një libër që pretendohet të jetë shkruar nga gjenerali Mike Jackson, ku shiheshin pjesëmarrësit e atij takimi. Dëshmitari Covey ka deklaruar para Gjykatës Speciale se nuk ka pasur asnjëherë një pasqyrë të qartë se kush ishte përgjegjës



për rajone të caktuara në UÇK dhe se kujt i raportonte ai person.

Covey ka pohuar se ishte e rëndësishme që ish-ushtarët e UÇK-së të integroheshin në forcën policore.

Më tutje, dëshmitari James Peter Covey ka deklaruar se Hashim Thaçi nuk ishte shef i Agim Çekut dhe se asnjërin nuk e ka parë duke i dhënë urdhra njëri-tjetrit.

Covey ka thënë se ata silleshin

në mënyrë korrekte me njëri-tjetrin, po ashtu edhe me rezerva. “Absolutisht jo. Sipas asaj që kam parë, ata silleshin në mënyrë korrekte me njëri-tjetrin. Nuk më kujtohet nëse kanë shkëmbyer fjalë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sigurisht që nuk e kam parë asnjëherë njërin që të jepte urdhër ose udhëzime tjetrit. Dukej sikur silleshin me rezerva njëri me tjetrin”, ka thënë ai.

Dëshmitari Covey ka mohuar se

e ka parë ndonjëherë Çekun të jetë udhëzuar me Thaçin lidhur me ndonjë gjë. Në dëshminë e tij, Covey ka deklaruar te Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i njohur si UNMIK, se nuk e ka trajtuar Hashim Thaçin si komandant. “Unë flas në emër të UNMIK-ut. UNMIK-u nuk e ka trajtuar atë si komandant”, ka thënë ai.

Krahas kësaj, gjatë dëshmisë së tij në Hagë, dëshmitari James Peter Covey ka treguar se

Hashim Thaçi e kishte dënuar dhunën e ushtruar ndaj pakicave etnike, sidomos gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1999. “Gjërat nuk kanë ndryshuar vetëm pse kemi arritur ne aty. Shumë gjëra ne i kemi mësuar me kalimin e kohës. Shpeshherë i kemi mësuar shumë gjëra vite më vonë. Kështu, që kur them që kjo gjë është në përputhje nuk është kjo gjë që e kam ditur në atë moment se kur kam arritur dhe, në fakt, më impresionon fakti që ato gjëra që ka thënë zoti Thaçi janë nga kjo koha e mëparshme. Kështu që ne nuk mund të themi që është roli ynë që e ka bërë që ai t'i thotë këto gjëra. Është një proces që kishte filluar përpara mbërritjes tonë”, ka thënë dëshmitari Covey.

Dëshmitari James Peter Covey ka folur edhe për persekutimin e romëve. Ai ka thënë se të gjitha palët gjenin justifikime sa i përket persekutimit të romëve, duke përfshirë edhe ata që ndodheshin në Evropë. Ndërsa në rastin e Kosovës, ai ka thënë se serbët i përdornin ata si vegla. Përpara kësaj, dëshmitarit i është paraqitur një dokument i cili ishte me shkrim të dorës e që i ishte dhënë dëshmitarit dhe Bernard Kouchnerit në Kosovë. Ky dokument, sipas avokatit të Thaçit, Luka Mishetiç, fliste për marrëdhëniet në mes të romëve dhe shqiptarëve etnik në Kosovë. James Peter Covey do të dëshmojë edhe sot (e mërkurë).

I ngarkuari me punë në Ambasadën e Gjermanisë interesohet për përgatitjen e zgjedhjeve lokale

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka pritur të martën në takim të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, Christian Boettcher. Takimi është zhvilluar në kuadër të angazhimeve të përbashkëta për forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e rëndësisë së

proceseve zgjedhore demokratike. Gjatë takimit, kryesuesi Radoniqi e informoi Boettcherin lidhur me përgatitjet që KQZ-ja është duke bërë për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve lokale. Kryesuesi Radoniqi shprehu angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për garantimin e një procesi zgjedhor të lirë, të

drejtë dhe transparent, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve demokratike në Kosovë. Nga ana e tij, Boettcher vlerësoi përpjekjet e KQZ-së për forcimin e demokracisë në vend dhe uroi sukses në organizimin e procesit zgjedhor.



URAN ISMAILI PARAQET 10 VENDIMET E PARA PËR PRISHTINËN SI KRYETAR I ARDHSHËM I KRYEQYTETIT

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, të martën ka mbajtur një konferencë për medie, ku ka theksuar se kryeqyteti ndodhet para një momenti vendimtar që kërkon vendime të guximshme dhe të menjëhershme. Ai ka paraqitur dhjetë vendimet e menjëhershme që do të marrë si kryetar i Prishtinës. “Prishtina nuk ka kohë për eksperimente, për kaos e bllokada që ua vështirësojnë jetën qytetarëve. Nuk ka kohë për konflikte dhe akuza të pafundme politike që e mbajnë peng nëpër gjykata. Nuk ka kohë për plane 10-vjeçare e projekte mega-futuristike. Prishtina ka nevojë për ndryshim, për guxim dhe për

një kryetar që u del zot punëve dhe zotimeve që jep”, tha Ismaili. Ai theksoi se ndryshimi për një Prishtinë funksionale do të nisë menjëherë pas 13 tetorit, me vendime që prekin drejtpërdrejt jetën e përditshme të qytetarëve. “Në fund të mandatit tim, qytetarët do të më matin me punë. Nëse nuk i realizoj 90 % të zotimeve, nuk do të kërkoj më kurrë vota për një mandat të dytë”, u shpreh ai. Ismaili paraqiti edhe 10 vendimet e para që do të ndërmarrë si kryetar i Prishtinës: Hapja e Sheshit “Xhorxh Bush” në javën e parë; Pezullimi i lejeve të reja ndërtimore për 6 muajt e parë; Fillimi i procedurave për krijimin e Qendrës Dixhitale të



Menaxhimit të Trafikut; Fillimi i procedurave për blerjen e 60 kamionëve të rinj për mbledhjen e mbeturinave;

Krijimi i taskforcës për ndriçimin e 1,000 rrugëve të Prishtinës; Fillimi i procesit për ndërtimin e një strehimoreje të

re për trajtimin e qenve endacakë; Fillimi i procedurave për vendosjen e 200 oficerëve të sigorisë në shkolla; Nënshkrimi i vendimit ekzekutiv për lirim të trotuareve të bllokuara; Krijimi i taskforcës për ndërtimin e Spitalit të Prishtinës; Nënshkrimi i vendimit ekzekutiv për dyfishimin e subvencioneve për fermerë dhe agrobiznese. Në fund të konferencës, Ismaili bëri edhe nënshkrimin formal të këtyre zotimeve, duke deklaruar se më 13 tetor nis një epokë e re për kryeqytetin. “Ka ardhur koha për një kryetar që çdo ditë merret me nevojat e Prishtinës dhe që nuk fshihet pas premtimeve të perealizueshme e planeve afatgjata”, tha ai.

FAKULTETI I FILOLOGJISË NDEROHET PËR KONTRIBUTIN E RRTJES SË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË



Prishtinë, 30 shtator - Të martën në ceremoninë e hapjes së Konferencës së 3-të Vjetore të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për Arsimin e Lartë dhe Sigurimin e Cilësisë, që po mbahet në Prishtinë, kryetarja e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), prof. Hasnije Ilazi dhe drejtori i AKA-së, Naim Gashi, i dorëzuan Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës mirënjohjen për kontribut në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Fakultetit tonë iu dha “Certifikata e Cilësisë” e lëshuar nga AKA dhe KShC “në shenjë njohjeje për arritje të spikatura

në përmbushjen e standardeve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”. Fusha për të cilën u vlerësua dhe u shpërblye Fakulteti i Filologjisë është “organizimi i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën Shqipe dhe ofrimi i kurseve për studiues ndërkombëtarë.” Vlen të theksohet se në konferencën me temë “Internationalised Higher Education: Overcoming Borders and Bringing People Together”, po trajtohet roli i ndërkombëtarizimit në kapërcimin e kufijve dhe në ndërtimin e urave të

bashkëpunimit mes njerëzve, kulturave dhe institucioneve. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, i themeluar në vitin 1974 në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, është një ndër institucionet më të rëndësishme dhe më jetëgjata të albanologjisë bashkëkohore. Për më shumë se pesë dekada, ky Seminar shërben si një platformë unike ndërkombëtare për mësimin, studimin dhe promovimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare në të gjitha dimensionet e tyre shkencore, kulturore dhe pedagogjike.

Fillon vaksinimi kundër gripit sezonal në Mitrovicë

MITROVICË, 30 SHTATOR - Drejtorja për Shëndetësi ka njoftuar se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë është furnizuar me 2 500 doza të vaksinës kundër gripit

sezonal nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës. Procesi i vaksinimit do të nisë nga 1 tetori. Vaksinimi ka për qëllim mbrojtjen e grupeve më të

rrezikuara, ku përfshihen: punëtorët shëndetësorë, personat mbi 65 vjeç, pacientët me sëmundje kronike, gratë shtatzëna, si dhe fëmijët mbi gjashtë muaj me imunitet të

dobësuar - gjithmonë me rekomandim të mjekut. Qytetarët mund të vaksinohen çdo ditë pune, nga ora 07:30 deri në 13:30, në qendra shëndetësore të komunës së Mitrovicës.



KOMF-i JEP PROPOZIME PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA KANDIDATËT PËR KRYETARË TË KOMUNAVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF, i cili përfaqëson 35 organizata joqeveritare, përmes këtij dokumenti adreson drejt kandidatëve për kryetarë të komunave dhe kandidatëve për kuvendet komunale çështjet prioritare për ndërhyrje në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në nivel komunal. Thuhet se këto propozime janë në përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi dhe obligimet ligjore të komunave që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Shëndetësi si dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal.

Mirëqenia dhe shërbimet sociale

“Komunat të rrisin buxhetin për thirrjet e ardhshme publike në komuna për mbështetjen e shërbimeve sociale për fëmijët e cenueshëm të ofruara nga sektori joqeveritar, si dhe të aplikojnë kontratat me kohëzgjatje trevjeçare. Që nga dhjetori i vitit 2023, për pjesën më të madhe të ofruesve të shërbimeve sociale kanë përfunduar programet e mbështetura nga donatorët ndërkombëtarë. Situata është rënduar edhe më shumë në vitin 2025, me vendimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për tërheqjen e ndihmës ndërkombëtare për shumë shtete në botë, përfshirë edhe Kosovën. Komunat, bazuar në kompetencat që u garanton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, të rrisin buxhetin për shërbime sociale”, thuhet në komunikatën e KOMF-it. Po ashtu thuhet se komunat duhet të rrisin numrin e zyrtarëve për shërbime sociale në kuadër të Qendrave për Punë Sociale, sidomos të atyre me profil të “punëtorit social” dhe



“psikologut”, për të përballuar ngarkesën e lëndëve si dhe për të mundësuar funksionimin e Organit të Kujdestarisë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. “Ky organ, sipas ligjit, duhet të përbëhet nga pesë profile profesionale të domosdoshme: punëtor social, psikolog, jurist, pedagog dhe sociolog. Qendrat për Punë Sociale vazhdojnë të jenë të mbingarkuara me reagim në raste emergjente – aktualisht, një zyrtar nga QPS në komunat e mëdha ka rreth 350 lëndë aktive në vit. Organi i Kujdestarisë në shumicën e komunave nuk është i kompletuar me profesionistë dhe nuk është funksional. Komunat të krijojnë kushte të përshtatshme pune për Qendrat për Punë Sociale, duke siguruar hapësirat dhe pajisjet e nevojshme, si dhe qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara në objektet e QPS-ve. Mbi 50% e Qendrave për Punë Sociale kanë qasje të vështirësuar ose të pamundur për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vetëm 28% e tyre kanë kushte infrastrukturore relativisht të mira, ndërsa pjesa tjetër ofrojnë shërbime në hapësira të papërshtatshme fizike. Komunat të ndajnë buxhet për themelimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Qendrave për Punë Sociale përkatëse, në komunat ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore, sipas përcaktimeve në Ligjin për

Mbrojtjen e Fëmijës”, thuhet në komunikatë.

Shëndeti

Sipas KOMF-it, komunat duhet të rrisin burimet për intensifikimin e programit të vizitave shëndetësore në shtëpi, për të mundësuar vaksinimin në shtëpi, mbështetjen e praktikave të gjidhënies, të ushqyerit e shëndetshëm si dhe identifikimin e problemeve shëndetësore tek fëmijët.

Thuhet se me theks të veçantë, kjo rritje e kapaciteteve të synoj arrijen e sa më shumë grave shtatzëna në dy vizitat e para të planifikuara, në kuadër të shtatë vizitave gjithsej të programit të vizitave shtëpiake. “Në këto vizita, gjatë tremujorit të fundit të shtatzënisë t'i jepet rëndësi informimit të grave mbi praktikën e mira të ushqyerjes me gj. Në Kosovë, vetëm 32% e të porsalindurve ushqehen me gj brenda orës së parë pas lindjes, ndërsa të ushqyerit vetëm me gj është prevalent vetëm për 29% të fëmijëve nën moshën 6 muajsh. Si pasojë e Covid-19, është regjistruar rënie e shkallës së imunizimit të rregullt në nivel global. Kjo rënie është evidentuar edhe në Kosovë dhe raportohet që ende Kosova nuk është në shkallën e mbulueshmërisë me vakcina të rregullta në nivelin para Covid -19. Komunat të ndajnë buxhetin për sigurimin e burimeve njerëzore brenda

sistemit parësor shëndetësor për realizimin e kontrollove sistematike në kopshte dhe shkolla që do të mbulojë çdo fëmijë pas moshës trevjeçare. Këto kontrolle sistematike të synojnë të identifikojnë në mënyrë të hershme rreziqet zhvillimore të fëmijët, si kequshqyerja, gjetjet antropometrike (peshë dhe gjatësi), shenjat e anemisë, nivelin e interaktivitetit, shëndetin oral, skringun zhvillimor, shikimin dhe dëgjimin, dhe zhvillimin e të folurit. Zbatimi i kontrollove do të mundësonte ndërhyrje të hershme dhe mbështetje adekuate për fëmijët dhe familjet e tyre”, thuhet në komunikatë, duke shtuar se komunat duhet të sigurojnë ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve në institucionet parashkollore, sipas Udhëzuesit Administrativ 02/2022 për planifikimin e ushqyerjes në institucionet parashkollore në Republikën e Kosovës. “Ushqyerja e shëndetshme në fëmijëri është thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e duhur fizik, mendor dhe emocional të fëmijëve, si dhe për krijimin e shprehive për një jetë të shëndetshme. Komunat duhet të ndajnë buxhet për të siguruar mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për fëmijët, përmes monitorimit të ndotjes së ajrit, krijimit të rrugëve të sigurta dhe zhvillimit të hapësirave të gjelbra pranë shkollave dhe në lagje”, theksohet në komunikatën e KOMF-it.

Edukimi i hershëm dhe arsimi

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF, ka theksuar se komunat duhet të planifikojnë buxhet për themelimin e institucioneve parashkollore dhe të rrisin përfshirjen e fëmijëve në nivelin parashkollor. “Komunat të sigurojnë vende në institucione parashkollore për fëmijët e cenueshëm dhe me aftësi të kufizuara. Vetëm 15% e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç marrin pjesë në programe të edukimit të hershëm. Fëmijët që vijnë nga grupet e marginalizuara edhe pse janë të liruar nga pagesa, shumë shpesh nuk përfshihen për shkak të kufizimit të numrit të fëmijëve. Komunat të rrisin numrin e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara, ashtu siç është paraparë në legjislacion. Numri aktual i asistentëve mbështetës mbetet ende i pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat në rritje. Shumë prindër detyrohen të sigurojnë asistentët mbështetës me të hyrat familjare, duke rënduar gjendjen ekonomike të familjes”, thuhet në komunikatë. Më tej thuhet se komunat të planifikojnë buxhet për largimin e barrierave fizike, me qëllim të sigurimit të qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla. “Nga 1,044 institucione arsimore, vetëm 609 prej tyre ofrojnë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Komunat të ndajnë buxhet për pajisjen e shkollave me mjete dhe materiale mësimore si dhe me teknologji digjitale, në mënyrë që të sigurohet mbështetja e mësimdhënies dhe të nxëniet efektiv. Shumica e shkollave në Kosovë nuk posedojnë teknologji digjitale për mbështetjen e mësimdhënies. Zbatimi i këtyre propozimeve do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e qasjes së fëmijëve në shërbime cilësore sociale, arsimore dhe shëndetësore, si dhe në fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel komunal”, është theksuar në komunikatën e KOMF-it.

Maqedonci në Varshavë paraqet sfidë rritjen e përdorimit të inteligjencës artificiale dhe rreziqet nga dezinformimi

VARSHAVË, 30 SHTATOR - Në ditën e dytë të punimeve të Forumit të Sigurisë në Varshavë, ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ishte folës në panelin me titull “Të lidhur, por të mbrojtur: Shtylla digjitale e demokracisë moderne”, ku bashkë me ministra dhe zëvendësministra nga Polonia, Danimarka, Ukraina,

Shqipëria dhe drejtues nga Ministria e Forcave të Armatosura të Francës, diskutuan për sfidat dhe mundësitë e epokës digjitale. Ministri Maqedonci theksoi rëndësinë e mbrojtjes gjithëpërfshirëse në fushën ushtarake dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në këtë proces. Ai përmendi si sfidë kryesore rritjen e përdorimit të

inteligjencës artificiale dhe rreziqet nga dezinformimi dhe ndërhyrjet e jashtme keqdashëse. Panelistët konfirmuan se vendet e Evropës ndjekin qasje të ndryshme ndaj këtyre sfidave, por bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave janë thelbësore për ta garantuar sigurinë dhe mbrojtjen digjitale.



Rreth 90 % të emetimeve të CO2 u liruan nga sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e hulumtimit statistikor “Llogaritë e Emetimeve në Ajër (LLEA) 2022”. Ky është publikimi i tretë i këtij lloji i realizuar në ASK. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të ofrojë të dhëna të qëndrueshme statistikore për llogaritë e emetimeve në ajër në Kosovë në ndërtimin e një sistemi statistikor për LLEA.

Ndërkaq, emetimet më të larta të CO2 në ajër nga të gjitha llojet e industrisë ishin: Sektori D (furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar) ishte përgjegjës përreth 90 % të emetimeve të CO2. Sektori C dhe Sektori F - Prodhimi dhe Ndërtimi, ishin përgjegjës për rreth 10 % të emetimeve të CO2. Rezultatet e paraqitura në këtë publikim ofrojnë një burim të

rëndësishëm statistikor për gjendjen aktuale të Llogarive të Emetimeve në Ajër (LLEA) nga sektorë të ndryshëm të industrisë në Kosovë. Metodologjia e përdorur për realizimin e publikimit është në përputhje me Rregulloren e BE-së (BE) nr. 691/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 6 korrik 2011, mbi Llogaritë Ekonomike Mjedisore Evropiane.



LUFTHANSA DO TË SHKURTOJË 4 000 VENDE PUNE

BERLIN, 30 SHTATOR - Industria gjermane është ende, siç thuhet në qarqet profesionale, “nën presion”. Pas njoftimit të fundit shqetësues nga Bosch për shkurtime masive të vendeve të punës, shqetësimi tjetër vjen nga Lufthansa. Siç njoftoi menaxhmenti më 29 shtator, rreth 4 000 vende pune janë planifikuar të shkurtohen deri në vitin 2030. Sipas kompanisë, fokusi i shkurtimeve të vendeve të punës do të jetë në administratë dhe jo në “punën operative”. Proceset administrative duhet të digjitalizohen, automatizohen dhe unifikohen. Me këtë u specifikuan dhe konfirmuan shqetësimet e shfaqura në publik pas spekulimeve për shkurtime në shoqërinë ajrore gjermane më e madhja në Evropë. Për më tepër, do të formulohen objektiva financiare më ambicioze afatmesme, prandaj planifikohen fitime më të larta. Lufthansa, e cila ka 103 000 punonjës, dëshiron të arrijë një fitim operativ prej tetë deri në dhjetë për qind të të ardhurave në të ardhmen. Deri më tani vlera e synuar ishte tetë për qind. Për vitin aktual, menaxhmenti është optimist: fitimi operativ duhet, siç është planifikuar, ta tejkalojë ndjeshëm shumën e vitit të kaluar



prej 1.6 miliard eurosh.

Menaxhim i centralizuar

Për ta arritur rritjen e planifikuar të të ardhurave, linjat ajrore të ndryshme që janë pjesë e koncernit duhet të unifikohen dhe të menaxhohen më fort në mënyrë të centralizuar. Përveç markës qendrore Lufthansa, e cila ka disa vështirësi, kompania përfshin edhe Swiss, Austrian, Brussels Airlines, e Lufthansa është, gjithashtu, aksionar i vogël edhe i kompanisë italiane Ita. Dega me kosto të ulët e Lufthansës, Eurowings, do të forcohet gjithashtu, si dhe

departamentet e saj të logjistikës dhe shërbimit dhe mirëmbajtjes së avionëve. Plani përfshin edhe aktivitet të shtuar në fushën e forcave ajrore, domethënë në mbrojtje. Qëllimi i të gjitha masave është të pozicionohet më mirë koncerni për të ardhmen dhe të sigurohen fitime të mira për aksionarët edhe në të ardhmen: ata ende mund të mbështeten në dividendë në shumën prej 20 deri në 40-përqindësh të fitimit të koncernit.

A do të ketë një grevë tjetër të pilotëve?

Megjithatë, menaxhmenti duhet

së pari të merret me grevën e afërt të pilotëve. Referendumi i sindikatës së pilotëve Vereinigung Cockpit (VC) përfundon të martën. Ai u bëri thirrje anëtarëve të tij në kompaninë mëmë Lufthansa dhe degën e ngarkesave Lufthansa Cargo të vendosin për grevë. Pika e mosmarrëveshjes janë pensionet. Lufthansa i hodhi poshtë kërkesat si të parealizueshme për shkak të kostove.

Bosch shkurton 13 000 vende pune në Gjermani

Në fund të javës së kaluar, furnizuesi më i madh në botë i pjesëve të automjeteve, Bosch, nga Gerlingen pranë Shtutgartit, njoftoi se planifikon të shkurtojë rreth 13 000 vende pune në fabrikat e tij në Gjermani, më shumë sesa ishte njoftuar më parë. Së bashku me shkurtime e njoftuara më parë, deri në fund të vitit 2030, do të shkurtohen rreth 22 000 vende. Në muajt e fundit kompania ka sinjalizuar vazhdimisht se ka teprica të konsiderueshme të fuqisë punëtore, veçanërisht në segmentet që lidhen me prodhimin e pjesëve për makina me motorë me djegie të

brendshme. Ndërsa industria e automobilave kalon më shpejt në automjete elektrike, kërkesa për lloje të caktuara të pjesëve dhe teknologjisë po bie. Rezultati është se në disa segmente prodhimi nevoja për punëtorë po zvogëlohet, ndërsa në të njëjtën kohë kërkesa për ekspertë në fushën e sistemeve të baterive, zgjidhjeve softuerike dhe efikasitetit të energjisë po rritet. Bosch punëson më shumë se 400 000 njerëz në të gjithë botën, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve është në Gjermani. Janë fabrikat gjermane, veçanërisht ato që lidhen me prodhimin e motorëve dhe komponentëve klasikë të automobilave, ato që do të preken më shumë nga shkurtime. Kompania thekson se qëllimi është të shmangen shkarkimet masive nga puna dhe se pëlqehen pensionet e parakohshme, rikualifikimi dhe transferimet e brendshme të punonjësve. Pavarësisht prej kësaj, punëtorët dhe sindikatat po shprehin shqetësim për pasigurinë e mundshme në punë dhe pasojat afatgjatë. (DW)

BQK-ja, Ambasada e Gjermanisë dhe GIZ-i diskutojnë mbi iniciativën për avancimin e infrastrukturës së sistemit financiar

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Dardan Fusha, ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Ambasadës së Gjermanisë dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në Kosovë. Delegacioni u udhëhoq nga Daniel Alker, shef i Bashkëpunimit në Ambasadë dhe David Oberhuber, drejtori i GIZ-it Kosovë.

Takimi u fokusua në iniciimin e projektit për modernizimin e infrastrukturës së sistemit financiar dhe zgjerimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet financiare. Guvernatori Ismaili ofroi informacione mbi zhvillimet e fundit në sektorin financiar, reformat në vazhdim të BQK-së, si dhe përparimin e arritur në realizimin e objektivave të Planit Strategjik. Diskutimet u përqendruan në projektin që synon forcimin dhe modernizimin e mëtejshëm të

BQK-së dhe infrastrukturës së sistemit financiar, në përputhje me objektivat e Planit Strategjik të BQK-së. Përfaqësuesit e institucioneve gjermane shprehën angazhimin për të bashkëpunuar me BQK-në në këtë projekt, në përputhje me objektivat e Qeverisë së Gjermanisë për mbështetjen e zhvillimit të sektorit financiar në Kosovë. Të dyja palët konfirmuan angazhimin për t'i vazhduar diskutimet për përgatitjen e



marrëveshjes së projektit dhe aranzhimeve të tjera teknike të

nevojshme për zbatimin e suksesshëm të tij.

ISHTË I VETMI PAKT I MUNDSHËM PËR PAQEN. POR KA NJË TË PANJOHUR



STEFANO STEFANINI

Plan “praktik dhe realist”: me dy fjalë Benjamin Netanyahu i dha dritën jeshile 20 pikave të Donald Trump-it për “t’i dhënë fund luftës në Gaza”. Me një kusht të vetëm: nëse Hamasi e refuzon, do ta çojmë deri në fund. Përndryshe, pranimi është i plotë, në dukje, pa rezervë. Kryeministri izraelit ka bërë pas në katër pika themelore: tërheqjen graduale të trupave izraelite nga Rripi, që do të zëvendësohen nga një Forcë Ndërkombëtare e Stabilizimit (ISF); mosdëbimin e banorëve të Gazës; mosanëksimin e Bregut Perëndimor; lënien të paprekur të perspektivës së dy shteteve. Është një kthim prapa që mund t’i sjellë kundërgoditje të brendshme, por e blinda në Uashington. Në Shtëpinë e Bardhë ishin të irrituar me Bibi-n. Mirëpo Netanyahu, i cili e ka tendosur litarin me të gjithë presidentët amerikanë, nga Bill Clinton e këtej, as kësaj radhe nuk e këputi. Ai u pajtua jo aq me një marrëveshje paqeje, se sa me një bazë negociuese që i lë njëfarë lirie veprimi. Nëse pastaj Lëvizja e Rezistencës Islamike nuk dorëzon armët dhe nuk i kthen pengjet, lufta vazhdon. Netanyahu nuk do të ankohet. Sot, megjithatë, ai e pranon planin e Trump-it.

Çfarë ka në plan? Hapi i parë është vendimtar. Që nga momenti i pranimi, Hamasi ka 72 orë për kthimin e të gjithë pengjeve, të gjallë ose të vdekur. Është shkëmbi mbi të cilin plani mund të ngecë, në mos të mbytet. Mbështetja e vendeve arabe-veçanërisht e Katarit, në një bisedë telefonike treshe Trump–Netanyahu–Al Thani, Emiri i Dohas-bën të mendohet se presionet mbi Lëvizjen janë tashmë shumë të forta. Nëse Izraeli nuk mund t’i thotë “jo” Trump-it, a mundet Hamasi ta bëjë me Tamim bin Hamad bin Khalifa Al Thanin? Duke e thjeshtuar në maksimum, plani përbëhet nga tri pjesë. E para, me ritme shumë të shpejta: përfundimi i luftës, rifillimi i ndihmave humanitare dhe mosdëbimi i popullsisë. E dyta, e ndërlikuar dhe krijuese, por edhe akrobatike dhe me rrezik: mbi menaxhimin, administrimin, rindërtimin dhe zhvillimin e Rripit, me përjashtimin e mirëkuptueshëm të Hamasit. Parashikon tre elemente: një komitet “teknokratësh palestinezë apolitikë”; mbikëqyrjen ndërkombëtare të një “Këshilli për Paqen”, të kryesuar, natyrisht, nga Donald J. Trump, me një rol të spikatur të Tony Blair-it; ISF-në, forcë për kontrollin e territorit që zë vendin e ushtrisë izraelite, për

të cilën Shtetet e Bashkuara “do të punojnë së bashku me partnerë arabë dhe ndërkombëtarë”. Këtu, çdo fjalë duhet peshuar: a do të thotë kjo se Trump do të vendosë në Rripin e Gazës forca amerikane, ato “çizme në terren” që ai ka thënë gjithmonë se nuk do t’i shihte më në Lindjen e Mesme, pas Irakut dhe Afganistanit? Kush janë partnerët “ndërkombëtarë” te të cilët do të drejtohet? Europeanët? Plani përmend “propozimin franko-saudit”, me gjasë të formuluar në sesionin plenar në Pallatin e Qelqtë, ku SHBA dhe Izraeli nuk merrnin pjesë; në konferencë për shtyp Trump ishte pazakontësisht bujar: “Europa ka qenë shumë e angazhuar në hartimin e planit për Gazën”. Nuk tha si dhe kush. Pjesa e tretë është politikisht më e kushtueshme në perspektivë. Ringjall zgjidhjen me dy shtete, megjithëse me gjuhë të përmbajtjes kur gjithë pjesa tjetër e planit të jetë vënë në vijë, do të kemi “kushtet për një rrugë të besueshme drejt vetëvendosjes dhe shtetësisë palestineze, të cilën e njohim si aspiratë të popullit palestinez”. Kjo, ndoshta, është kafshata më e hidhur që Netanyahu duhej të gëlltiste. Por me një rrugë shumë të gjatë për të mbërritur deri atje. Pjesa e parë është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme. E dyta - e

stërkomplikuar, plot kurthe-do të kërkojë investime të mëdha vullneti të mirë, një përbërës i rrallë në Lindjen e Mesme, nga të gjitha palët; por diku duhet filluar. E treta ringjall planin me dy shtetet që dukej i varrosur nën kasaphanën e 7 tetorit dhe rrënojat e Rripit. Plani i Trump-it hap, pra, një fije drite për paqe dhe rindërtim për dy milionë palestinezët e Rripit. Ndoshta kompenson izolimin e Benjamin Netanyahu-t në Kombet e Bashkuara dhe legjitimon tiradën e Donald Trump-it mbi padobishmërinë e OKB-së: për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, Zyra Ovale peshon më shumë se Asambleja e Përgjithshme. Çmimi ka qenë jashtëzakonisht i lartë. Në jetë njerëzish, vuajtje të papërshkrueshme, kequshqyerje fëmijësh, miliona tonelata rrënoja në Gaza. Në akumulimin e urrejtjes dhe dëshirës për hakmarrje në tokën e “sy për sy, dhëmb për dhëmb”. Në fatin e pengjeve ende gjallë, të varur në një fije peri. Në izolimin ndërkombëtar të Izraelit. Në pulsime antisemite të mbuluara si pro-Palestinë. Në koston gjeopolitike të copëtimit në rritje të Perëndimit dhe të përçarjes transatlantike. Sa do të mund të ishte kursyer po të arrihej muaj më parë? Por historia nuk bëhet me “sikur”, bëhet me ç’ka

ndodhur. Plani i Trump-it është tani pika e nisjes. Kush e ka për zemër paqen në Lindjen e Mesme dhe të ardhmen e Palestinës nuk mund veçse të shpresojë që të dalë mbarë. Gaza ka më në fund një plan paqeje që mban firmën e Donald Trump-it dhe të diplomacisë së tij jo ortodokse. Me dy virtyte të mëdhenj. I pari, për popullsinë e martirizuar të Gazës është një rrugëdalje nga ferri. I dyti, Netanyahu detyrohet të tërheqë mohimin e shtetit palestinez. Europeanëve, ende në grindje se ç’të bëjnë, çfarë mesazhi t’i japin Izraelit, ç’mazhoranca duhen për sanksione, s’u mbetet veçse të ndalin e të ndihmojnë suksesin e planit të Trump-it për Gazën. Është e vetmja ofertë në tryezë. Duke shpresuar që kjo shkëndijë arsyeshmërie të shkreprijë edhe në mendjet e lundruesve të Flotilla Sumud. A duan vërtet të rrezikojnë një incident që do të nxirrte nga shinat këtë perspektivë të brishtë paqeje, e hapur dje në Zyrën Ovale? Ky është momenti për t’u kthyer kah ndërmjetësimet e Presidentit Sergio Mattarella dhe të Patriarkut Pierbattista Pizzaballa. Ose për t’u penduar nëse dy milionë banorët e Gazës e humbasin këtë mundësi delikate paqeje. / La Stampa – Bota.al

RRJETI I BLAIR-IT NË LINDJEN E MESME. “MISSION IMPOSSIBLE” I FUNDIT NË GAZA




Në qershor të vitit 2007, Tony Blair, brenda të njëjtës ditë, dha dorëheqjen si Kryeministër britanik dhe njoftoi se kishte pranuar emërimin si i dërguar i posaçëm për Lindjen e Mesme, në përfaqësim të të ashtuquajturit Kuartet, pra OKB-së, Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Rusisë. Një kalim që, dukshëm, e kishte përgatitur prej kohësh, por që shkaktoi shumë habi. Ishte ai, i vetmi kryetar qeverie perëndimor, që i shkoi pas George W. Bush-it, duke dërguar në vitin 2003 edhe trupat britanike për të pushtuar Irakun e Saddam Husseinit-një hakmarrje e kotë për sulmin terrorist ndaj Kullave Binjake të Nju Jorkut. Një aventurë gjakderdhëse që njollosi trashëgiminë politike të Blair-it, një burrë shteti i cili në kufi të mijëvjeçarëve kishte

shënuar “Cool Britannia”-n, firmosi paqen në Irlandën e Veriut, solli devoluimin për Skocinë, Uellsin dhe Ulsterin, futi pagën minimale dhe dhjetëra reforma të tjera. Lufta në Irak, pra, nuk ishte aspak një kartë e mirë prezantimi për detyrën e re pranë Kombeve të Bashkuara. Një barrë tepër e rëndë, edhe për ndërgjegjen e tij. Ndoshta e zgjodhi detyrën e të dërguarit për Lindjen e Mesme edhe për të shlyer atë të shkuar. Atij iu desh të përballej me një konflikt izraelito-palestinez të futur në fazë të re, pas dorëzimit të Gazës te palestinezët, gjë që ishte vendosur nga kryeministri izraelit Sharon në vitin 2005 dhe pas marrjes së pushtetit nga Hamasi në Rripin e Gazës. Kështu, Blair nuk mundi të bënte shumë. Kuarteti i vendeve dhe organizatave, te të cilat ai

referohej, ishte pak më shumë se një skenografi prej kartoni. Kishte hapësirë vetëm për të provuar nisma bashkëpunimi ekonomik, si projekti “Lugina e Pagues”, investime për Izraelin, Jordaninë dhe Autoritetin Palestinez. Emër sugestionues, por pak substancë. Shumë, përkundrazi, ishin polemikat që thoshin se ai qe tepër pranë qeverisë izraelite. Dha dorëheqjen pas tetë vitesh; detyra gjasat e ka zhgënjyer, por i ka sjellë gjithashtu kontakte e njohje në rajon. Rrjeti i bashkëpunimeve të tij jo vetëm që nuk u shua, por madje u zgjerua nën ombrellën e Institute for Global Change. Ujdi fitimprurës me vendet e Gjirit. Akuza se synonte kryesisht buxhete milionëshe dhe komisione “të arta”. Për këtë arsye nuk habiti kur

muajt e fundit emri i tij nisi të qarkullonte sërish në bisedimet amerikane për periudhën pas Hamasit në Gaza. Në pranverë, dhëndri i Trump-it dhe ndërmjetësi i tij me vendet arabe, Jared Kushner, ia besoi pikërisht Institutit të Blair-it një studim fizibiliteti për rindërtimin e Rripit. Në fund të gushtit, ish-Kryeministri ishte në Shtëpinë e Bardhë për një mbledhje me Trump-in dhe të dërguarit e tij për Lindjen e Mesme. Me shumë gjasë janë urbanistët, inxhinierët dhe arkitektët e tij pas projektit të “Gaza Riviera”. Kur në rrjete sociale u shfaq videoja e shëmtuar që përqeshte tragjedinë e banorëve të Gazës, me Trump-in dhe Netanyahun që merrnin rreze në plazh, nga selia londineze e Blair-it u shpërnda një shënim i sikletshëm. U saktësua se projekti i tyre nuk

parashikonte deportimin e banorëve. Nuk mjaftoi për të shuar polemikat që në vendlindje vazhdojnë ta pikturojnë Blair-in tashmë vetëm si “afarsit”. Vështirë, në fakt, të mendohet se, edhe në rast marrëveshjeje me Hamasin, propozimi i ri nuk do të përkonte me një pastrim etnik de facto. Nëse Blair, me angazhimin e tij në Lindjen e Mesme, dëshiron të ndreqë dëmet e bëra në atë rajon të trazuar me zgjedhjet e tij të dikurshme qeverisëse, do t'i duhet të angazhohet personalisht shumë më tepër se sa me një projekt në letër. Tranzicioni për Gazën, ku ai shihet i përfshirë, paraqitet pothuaj si një “mission impossible”. Kush e di nëse do të ketë autoritetin dhe fuqinë e mjaftueshme, në “bordin e Gazës” ku, sidoqoftë, president do të jetë Donald Trump. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Genc Nuza, gjyqtar kryesor në Lausanne - Breidablik

Prishtinë, 30 shtator - UEFA vazhdon t'u besojë gjyqtarëve nga Kosova në garat evropiane. Genc Nuza, një nga gjyqtarët më të mirë në Kosovë, do ta ndajë drejtësinë në fazën e Ligës së Konferencës, duke

drejtuar ndeshjen Lausanne - Breidablik që zhvillohet në Zvicër. Prishtinasi do ta ketë pranë tij një ekip të plotë gjyqtarësh kosovarë. Asistentë do të jenë Bujar Selimaj dhe Fatlum

Berisha, ndërsa gjyqtar i katërt është Erdall Zasella. Në VAR dhe AVAR do të jenë Darsan Qaka dhe Visar Kastrati, duke garantuar drejtësi maksimale gjatë gjithë ndeshjes. Takimi mes Lausanne dhe Breidablik

zhvillohet të enjten, duke filluar nga ora 18:45. Prania e gjyqtarëve kosovarë në këto gara tregon se gjyqtarët e vendit po fitojnë gjithnjë e më shumë besim dhe respekt në arenën evropiane.



FIFA VENDOS: 6 500 TIPOZË NË NDESHJEN SERBI - SHQIPËRI




PRISHTINË, 30 SHTATOR - Ndeshja në mes të Serbisë dhe Shqipërisë, e cila do të zhvillohet më 11 tetor në stadiumin "Dubocica" të Leskovcit, do të luhet në praninë e vetëm 6 500 tifozëve. Komisioni Disiplinor i FIFA-s ka vendosur të mbyllë një pjesë të stadiumit pas incidenteve të shumta në ndeshjen e fundit të Serbisë kundër Anglisë. Përveç kësaj mase, Federata e Futbollit e Serbisë është dënuar edhe financiarisht. Stadiumi në

Leskovc ka kapacitet prej 8 136 vendesh, por për këtë takim do të lejohen vetëm 80 për qind e tyre. Në sfidën kundër Anglisë, e cila është luajtur në Beograd përpara 40 mijë tifozëve, pati shkelje të shumta: fyerje ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, fishkëllima ndaj himnit anglez, si dhe incidente të dhunshme të grupeve kriminale të afërta me pushtetin aktual serb. Në atë ndeshje, ku Serbia është mposhtur 5:0, kishte edhe fyerje

ndaj selektorit Dragan Stojković. FIFA ka paralajmëruar federatën serbe për dënime shumë më të rënda në rast se përsëriten incidente në sfidën kundër Shqipërisë. Pikërisht për këtë arsye është zgjedhur stadiumi i vogël në Leskovc, në vend të ndonjë stadiumi më të madh në Beograd, duke synuar kontroll më të madh mbi shitjen e biletave dhe shmangien e grupeve që kundërshtojnë pushtetin e Aleksandër Vuçiqit.

PALESTRA DO TË BËHET QENDËR VOTIMI, RAHOVECI I DETYRUAR T'I LUAJË NDESHJET EVROPIANE JASHTË VENDIT

RAHOVEC, 30 SHTATOR - Si zakonisht, palestrat sportive në Kosovë në kohën e zgjedhjeve, qofshin ato nacionale apo lokale, përdoren si qendra të votimit, krahas shkollave. E një gjë e tillë do të ndodhë edhe në zgjedhjet lokale që po afrojnë. Për këtë arsye Klubi i Hendbollit Rahoveci do të jetë i detyruar që ndeshjet ndërkombëtare t'i zhvillojë jashtë vendit. Rahoveci ka dalë me një njoftim duke treguar se të dyja ndeshjet me ekipin nga Luksemburgu, Dudelange në garat evropiane do t'i luajë në Luksemburg pasi që nga sot (e mërkurë) palestra "Mizahir Isma" do të kalojë në menaxhim të KQZ-së. "Për shkak



të zgjedhjeve, palestra 'Mizahir Isma' kalon në menaxhim të KQZ-së, rrjedhimisht, nuk mund të zhvillohet asnjë ndeshje aty. Për pasojë, jemi të detyruar që të dyja ndeshjet ndaj ekipit nga

Luksemburgu Dudelange, në kuadër të garave evropiane, t'i zhvillojmë në Luksemburg. Për detajet e tjera të ndeshjes ju njoftojmë me kohë", ka njoftuar Rahoveci.

MALISHEVA PËRFORCOHET ME NJË ARGJENTINAS

MALISHEVË, 30 SHTATOR - Malisheva është përforcuar me një futbollist argjentinas. Klubi i Superligës ka njoftuar se e ka transferuar futbollistën Agustin Rojas, për të cilin futbollit në Kosovë nuk është i panjohur ngaqë kishte luajtur për Prishtinën e Re. Gjithashtu, ka luajtur edhe në Superioreen shqiptare me Erzenin. Malisheva i ka uruar mirëseardhje futbollistit të rritur në Racing në Argjentinë, ndërsa pret shumë nga ai, duke uruar që bashkërisht t'i arrijnë objektivat e këtij sezoni. Rojas ka gjasa të debutojë në ndeshjen ndaj Llapit, që Malisheva e luan në shtëpi këtë javë në kuadër të xhiros së tetë të elitës së futbollit të Kosovës.



Pas shtatë ndeshjeve të luajtura në Superligë këtë sezon, Malisheva renditet e pesta në tabelë me 10 pikë të tubuara.

Izraeli mbetet në garat ndërkombëtare të futbollit

JERUSALEM, 30 SHTATOR - Votimi për përjashtimin e ekipeve izraelite nga garat ndërkombëtare nuk është bërë dhe nuk do të bëhet, që do të thotë se Maccabi nga Tel Avivi do të vazhdojë të luajë në Ligën Evropiane, dhe kombëtarja do të luftojë për një vend në Kupën e Botës 2026. Edhe pse "Associated Press" ka treguar pesë ditë më

parë për probabilitetin e lartë të sanksioneve kundër Izraelit për shkak të gjenocidit në Palestinë, Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s ende nuk është ulur për të biseduar.

Nga ana tjetër, Këshilli i FIFA-s nuk ka asnjë pikë në rendin e ditës për të diskutuar përjashtimin e Izraelit nga faza kualifikuese e Kupës së Botës

2026. Gazeta "Marca" e ka lidhur këtë situatë me presionin e fortë të presidentit amerikan, Donald Trump, ndaj njeriut të parë të FIFA-s, Gianni Infantino, për shkak të organizimit të Kupës së Botës që do të zhvillohet së shpejti. Pavarësisht prej njoftimeve, UEFA nuk e ka mbajtur një takim ekzekutiv urgjent, i cili është diskutuar

gjatë muajit të kaluar kryesisht me kërkesë të federatave individuale. UEFA dhe FIFA ende nuk kanë bërë njoftime zyrtare, kështu që ndërkohë Maccabi do të presë Dinamon në Backa Topola në raundin e dytë të Ligës së Evropës, ndërsa Izraeli do të luajë ndeshje me Italinë dhe Norvegjinë. Si kujtesë, që nga viti



2022, për shkak të luftës në Ukrainë, ekipet ruse dhe kombëtarja e tyre nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në garat ndërkombëtare.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar/e i/e lartë për prokurim dhe kontraktim
Grada: D09
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Divizioni: Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit
Raporton: Udhëheqësit të Divizionit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zyrtari/-ja i/e lartë për prokurim dhe kontraktim do të zbatojë detyrat profesionale nën mbikëqyrje dhe me udhëzime nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Ai/Ajo do t'i raportojë udhëheqësit të divizionit.
- Do të zbatojë Rregullën për Prokurimin në BQK dhe veçanërisht pjesën e kontraktimit siç aplikohet në BQK.
- Do të hartojë kontratat e prokurimit në harmoni me Rregullën e prokurimit dhe në përputhje me kushtet e tenderëve.
- Do të propozojë kushte të veçanta për kontratat e prokurimit sipas natyrës së prokurimit dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare të prokurimit.
- Do të monitorojë implementimin e kontratave sipas kushteve të caktuara duke ofruar opinione dhe interpretime profesionale rreth zgjidhjes së situatave.
- Do të propozojë forma dhe përmbajtje adekuate të kontratave të prokurimit sipas zhvillimeve të reja dhe standardeve vendore e ndërkombëtare.
- Do të përgatit dokumentacionin për prokurim (dosjet e tenderit, procesverbalet, njoftimet për kontratë, kontratat e prokurimi dhe njoftimet e tjera, formularët, etj.) sipas udhëzimeve që jepen në Rregull dhe sipas kushteve të tenderit.
- Do të përgatit dokumentacionin e nevojshëm të prokurimit për publikim, si: njoftimet për kontratë, njoftimet për dhënie të kontratës, etj. dhe koordinon afatet kohore të aplikueshme në harmoni me Rregullën e prokurimit.
- Do të kujdeset për organizimin dhe menaxhimin e seancave të hapjes publike të ofertave, mbajtjen e procesverbaleve dhe përgatitjen e dokumenteve tjera përcjellëse.
- Do të kujdeset për komunikim korrekt, të saktë dhe zyrtar me palët e jashtme – operatorët ekonomik si edhe me palët brenda BQK-së.
- Do të merr pjesë duke asistuar tek komisionet në seancat e hapjes së ofertave, pastaj asiston komisionet gjatë proceseve të vlerësimit të ofertave sipas procedurave përkatëse.
- Do të mirëmbajë dokumentacionin për secilën procedurë me evidencë për tërë proceset e prokurimeve në mënyrë të plotë dhe të saktë kronologjike.
- Do të përgatit raporte të rregullta periodike (javore, mujore, e vjetore) për aktivitetet e prokurimit.
- Sipas kërkesave dhe udhëzimeve të mbikëqyrësit direkt do të kryejë edhe detyra të tjera që lidhen me procedurat dhe proceset e prokurimit dhe kontraktimit.

Kualifikimet themelore dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë (juridik), në fushën e ekonomisë apo të ngjashme.
- Certifikim profesional në fushën e prokurimit është përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Së paku 2 (dy) vite përvojë profesionale në prokurim.

Kërkesa të veçanta:

- Aftësi të mira komunikimi në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve.
- Aftësi të mira analitike dhe krahasuese.
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme, e-Prokurimi, etj.
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale.
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi.
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formulari zyrtar i BQK-së për aplikim, i cili plotësohet gjatë aplikimit online;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 tetor 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naslov: Viši službenik za nabavke i ugovaranje
Rang: D09
Trajanje zaposlenja: Na neodređeno vreme
Odeljenje: Odeljenje za nabavku i ugovaranje
Izveštava: Rukovodioci odseka

Dužnosti i odgovornosti:

- Viši službenik za nabavke i ugovaranje obavlja profesionalne dužnosti pod nadzorom i uputstvima direktnog supervizora. On/ona će izveštavati rukovodiocu odseka.
- Sprovodi Uredbu o javnim nabavkama u CBK-u, a posebno deo o ugovaranju kako se primenjuje u CBK-u.
- Sastavlja ugovore o javnim nabavkama u skladu sa Uredbom o javnim nabavkama i u skladu sa uslovima tendera.
- Predlaže posebne uslove za ugovore o javnim nabavkama u skladu sa prirodom nabavke i u skladu sa najboljim međunarodnim standardima javnih nabavki.
- Prati sprovođenje ugovora prema određenim uslovima, pružajući stručna mišljenja i tumačenja o rešavanju situacija.
- Predlaže odgovarajuće oblike i sadržaj ugovora o javnim nabavkama u skladu sa novim dešavanjima i lokalnim i međunarodnim standardima.
- Priprema dokumentaciju o javnim nabavkama (tenderske dosijee, zapisnike, obaveštenja o ugovorima, ugovore o javnim nabavkama i druga obaveštenja, obrasce itd.) u skladu sa uputstvima datim u Uredbi i u skladu sa uslovima tendera.
- Priprema potrebnu dokumentaciju za javne nabavke za objavljivanje, kao što su: obaveštenja o ugovoru, obaveštenja o dodeli ugovora itd. i koordiniraće važeće rokove u skladu sa Uredbom o javnim nabavkama.
- Stara se o organizaciji i upravljanju sesija javnih otvaranja ponuda, vođenju zapisnika i priprema ostale prateće dokumentacije.
- Stara se za ispravnu, tačnu i zvaničnu komunikaciju sa spoljnim stranama - ekonomskim operaterima, kao i sa stranama unutar CBK-a.
- Učestvuje tako što će pomagati komisijama u sesijama otvaranja ponuda, a zatim će pomagati komisijama tokom procesa evaluacije ponuda u skladu sa relevantnim procedurama.
- Vodi dokumentaciju za svaku proceduru sa dokazima za sve procese nabavke na potpun i tačan hronološki način.
- Priprema redovne periodične izveštaje (nedeljne, mesečne i godišnje) o aktivnostima nabavke.
- Prema zahtevima i uputstvima neposrednog supervizora, on/ona će obavljati i druge zadatke vezane za postupke i procese nabavke i ugovaranja.

Potrebne osnovne i stručne kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava, ekonomije ili slično.
- Profesionalna sertifikacija u oblasti javnih nabavki je prednost.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno stručno iskustvo:

- Najmanje 2 (dve) godine stručnog iskustva u javnim nabavkama.

Posebni zahtevi:

- Dobre pismene komunikacijske sposobnsoti i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima.
- Dobre analitičke i uporedne veštine.
- Odlično poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office-a i slično, elektronskih javnih nabavki itd.
- Osoba sa visokom etikom i spsobna za čuvanje profesionalne poverljivosti.
- Pažnja posvećena detaljima, jasno formulisanje i tačnost.
- Samoinicijativa i spremnost za rad u timu.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu, koji se popunjava tokom onlajn prijave;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje zauzete pozicije i radnog iskustva, bez ugrožavanja na relevantne zakone o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova.

Postupak aplikacije:

- Rok za aplikaciju je **16. oktobar 2025. godine**.
- Prijava se može podneti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi obrasci prijave neće biti uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gieipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jeton Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zef Lush Marku”, Gjakovë.
- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.
- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.
- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.
- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.
- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.
- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.
- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.
- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.
- “Fire Protection Agency Rifel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.
- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

